



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:149270
Datë: 22.04.2024
Numri i dokumentit: 05601305

Ac.nr.7401/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Naime Ahmeti kryetare e kolegjit, Rafet Haxhaj dhe Malsor Kryeziu, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit V.R. nga Dragashi, Komuna e Prizrenit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson A.H. avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë me seli në Prishtinë, lidhur me kompensimin e shujtave, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2366/2022 të datës 28.09.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 17.04.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pa themeltë ankesa e të paditurës Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2366/2022, i datës 28.09.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me Aktgjykimin e atakuar ka vendosur si vijon:

‘I.APROVOHET në tërësi si e bazuar *kërkesëpadia e paditësit V.R. nga Prizreni si dhe*

II.DETYROHET e paditura Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë që paditësit në emër të shujtave ditore për 265 ditë pune për periudhën kohore prej 01.01.2020 deri me datën 31.12.2021 të ia kompensoj shumën e përgjithshme në vlerë prej 530,00 €të gjitha këto, në afat prej 7ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

III.DETYROHET e paditura që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë në shumën prej 124.00 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimi të aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura në afatin e paraparë ligjor ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë në tërësi si të bazuar ankesën e të paditurës të ndryshohet Aktgjykimi i atakuar si dhe të refuzohet në tërësi si e pabazuar padia e paditësit.

Përgjigje në ankesë ka ushtruar i autorizuari i paditësit me propozim që të refuzohet ankesa e të paditurës të vërtetohet aktgjykimi i atakuar si dhe të obligohet e paditura që t'i paguaj shumën prej 208 euro për përpilimin e Përgjigjes në ankesë sipas nr. tarifor 6 lidhur të nr. tarifor 9 të rregullores së avokatëve.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- Ankesa është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi përmes përfaqësuesit të autorizuar ka ushtruar padi me datë 12.07.2022, me të cilën ka kërkuar që të aprovohet në tërësi e bazuar kërkesëpadija e paditësit të detyrohet e paditura që paditësit për 265 ditët e pranisë në punë, për periudhën kohore prej 01.01.2020 deri me datën 31.12.2021 t'ia kompensoj nga 2 euro për ditët e prezencës në punë, me kamatë ligjore si dhe shpenzimet e procedurës.

Nga ana tjetër e paditura me përgjigje në padi e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit në kuptim të nenit 78 të Ligjit të Punës, si dhe nga fakti se e paditura nuk ka mundësi buxhetore për pagesën e kërkesës së paditësit.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditësit, përgjigjes në padi të të paditurës shqyrtimit të provave në shkresa të lëndës, si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, konform nenit 398 të LPK-së jashtë shqyrtimi gjyqësor, ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm përkitazi me vendosjen si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në shkeljet nga nenit 182 paragrafi 2 pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së dhe rrjedhimisht nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat janë pretenduar nga pala ankuuese.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadsisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe disa fakte vendimtare nuk kanë qenë kontestuese. Nuk ka qenë kontestuese në mes palëve se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura dhe atë në vendin e punës në cilësinë e mësimdhënësit në Qendrën Burimore për mësim dhe Këshillim “Lef Nosi” në Prizren, fakt i vërtetuar sipas kontratës së punës dhe vërtetimit me numër protokoll 18/22, të datës 11.03.2022. Po ashtu nuk ka qenë kontestuese se paditësi ka qenë prezentë në punë dhe ka gjithsejtë 265 ditë pune. Kontestuese nga e paditura ka qenë pa mundësia buxhetore për pagesën e kërkesave që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, për arsye se me: dispozitën e nenit 67 paragrafi 1 të Ligjit të Punës 03/L - 212 datës 01.11.2010, përcaktohet se *Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndemjet a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve*. Me paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet se: *Marrëveshja Kolektive mund të lidhet: në a) nivel të vendit, b) në nivel të degës, c) nivel të ndërmarrjes*, Me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se *“Marrëveshja duhet të jetë në formë të shkruar, në Gjuhën Zyrtare të Republikës së Kosovës”*. Me paragrafin 4 përcaktohet se: *Marrëveshja Kolektive vlenë për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive*’.

Me dispozitën e nenit 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 është e paraparë se: *‘Të punësuarve u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë, për një ditë pune dy (2) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në Institucionet Arsimore. Punëdhënësi i cili e ka rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit apo kuzhinës ose në ndonjë formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim*’.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e aprovimit të kërkesëpadsisë, duke e detyruar të paditurën që paditësit në emër të kompensimit të shujtave ditore për gjithsejtë 265 ditë pune t’ia kompensoj shujtat ditore, me të drejtë është bazuar në dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, të lidhur dhe nënshkruar nga Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK-ut) dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës (MASHT), e cila kontratë ka qenë në fuqi me rastin

e parashtrimit të kërkesës për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit për ditët në punë, që rrjedhimisht nënkupton se kjo Kontratë shërben si akt nga i cili buron themelësia e kërkesëpadisë.

Pretendimi ankimor i të paditurës se për periudhën kohore pas datës 18.04.2020, paditësit nuk i takon kompensimi i shujtave, pasi që Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë nuk ka qenë në fuqi, është i paqëndrueshëm, për faktin se paditësi padinë e ka parashtruar në gjykatë me datë 22.07.2022, ndërsa Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe ka qenë në fuqi deri me datë 18.04.2020, dhe në bazë të nenit 45 të kësaj kontrate është paraparë se “ *Nëse nga Kontrata Kolektive pasi ti skadojë afati i përcaktuar, nuk tërhiqet asnjëra nga palët, zbatimi i saj vazhdon edhe për një vit, Këtë fakt e ka vërtetuar edhe qëndrimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, referuar mendimit juridik të saj (mendimi juridik për shpërblim jubilar dt.27.02.2023, faqja 2, parag.IV), ku parashihet se: ‘Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e lidhur më datë 18.04.2017, të lidhur dhe nënshkruar nga Organizatat e të punësuarve (Sindikata e Bashkuar e Arsimit Shkencës dhe Kulturës), si dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, (Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë), (në tekstin e më tejme: Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017) aplikohet në periudhën kohore nga data 18.04.2017-21.01.2021’*”, ndërsa kërkesa e padisë ka qenë për periudhën kohore prej 01.01.2020 deri me datën 31.12.2021, kështu që pretendimi ankimor i të paditurës se kërkesa e paditësit është vjetërsuar, është i paqëndrueshëm për faktin se paditësi kërkesën për shujta e ka brenda periudhës së Marrëveshjes Kolektive e Arsimit, e cila ka hyrë në fuqi prej datës 18.04.2017, dhe kjo e drejtë paditësit i ka filluar prej kësaj date, e deri në datën e parashtrimit të padisë në gjykatë nuk ka parashkrim për periudhën kohore të kërkuar me padi.

Gjykata e Apelit, mori parasysh pretendimin ankimor të të paditurës lidhur me faktin se Kontrata Kolektive e Arsimit nuk është obligative për të paditurën, për arsye se nuk janë përmbushur kushtet e parapara me nenin 46 të kësaj Kontrate, meqenëse nënshkruesit e kësaj kontrate siç janë MASHT-i, SBASHK-u dhe Ministria e Financave nuk janë angazhuar asnjëherë për zbatimin e dispozitave që janë implikime financiare. Lidhur me këto pretendime, Gjykata e Apelit vlerëson se referuar dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, rrjedh se obligimi për përmbushjen e të drejtave të të punësuarve të parapara me këtë Kontratë, i takojnë pikërisht punëdhënësit, që në rastin konkret i bie të jetë e paditura. Në këtë pikëpamje, çfarëdo vështirësie që i atribuohet implikimeve financiare lidhur me zbatimin e kësaj Kontrate, nuk e liron të paditurën nga përgjegjësia për përmbushjen e obligimit në raport me kërkesën e paditësit, gjegjësisht nuk paraqet bazë që kërkesëpadia të trajtohet si e pa themeltë.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitën nga neni 452.1 të LPK-së, ndërsa veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese janë arsyetuar drejtë, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet tjera ankimore, por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragrafi 1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E AELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.7401/2023, me datë 17.04.2024

**Kryetare e Kolegjit
Naime Ahmeti, d.v.**